

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË "MOMO RENT" SH.P.K.

Sot, me datë 11.02.2025

Z. Arbër Liçaj, atësia Bilal, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në TIRANË, me adresë Rruga “Shyqyri Brari”, Tiranë, lindur më 03.05.1985, gjendja civile beqar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Letërnjoftimi ID nr. personal I50503079J.

Z. Xhon Miri, atësia Zef, shtetas Shqiptar, lindur në Velipoje dhe banues në SHKODËR, Shqipëri me adresë Lagjja 3 Heronjtë Rruga ‘Gerej’, Shkodër, lindur më 29.08.1988, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Letërnjoftimi ID nr. personal I80829093T.

Z. Bujamin Ejupi, atësia Feta, shtetas Maqedonas, lindur në Shkup dhe banues në Shkup, me adresë Rruga ‘Zef Lush Marku’ Nr.10, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Letërnjoftimi ID nr. personal NO446743

.

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**MOMO RENT**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**MOMO RENT**" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Shoqëria ka seli në Durrës, në adresën: Rruga e Rinasit, ndodhur në Zonën Kadastrale me Nr. 3183, me Nr. 65/14 pasurie, Krujë, Shqipëri.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Shoqëria, mund të kryejë dhenie me qera dhe shit-blerje të automjeteve të kategorive të ndryshme si: autovetura, furgona, minibuset, autobuset dhe kamiona. Mund të hyjë në tratativa dhe biznese me shoqëri të tjera që kanë të njëjtin objekt veprimtarie për të realizuar fitime në fushat e përmendura në këtë nen.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 100 Lek dhe është i ndarë në 4 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100 (njëqind) lekë, i ndarë në 4 (katër) kuota me vlerë nominale të një kuota prej 25 (njëzetë e pesë) lekë.

- **Z. Arbër Liçaj** zotëron 1 kuota të kapitalit themeltar, pra 25 % të tij në vlerën 25 (njëzetë e pesë) lekë.

- **Z. Xhon Miri** zotëron 1 kuota të kapitalit themeltar, pra 25 % të tij në vlerën 25 (njëzetë e pesë) lekë.

- **Z. Bujamin Ejupi** zotëron 2 kuota të kapitalit themeltar, pra 50 % të tij në vlerën 50 (pesëdhjetë) lekë.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Arbër Liçaj** i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar **Z. Arbër Liçaj**, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. I50503079J, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Arbër Liçaj

Z. Xhon Miri

Z. Bujamin Ejupi

